

Te dashur vellezer dhe motra!

Vella Kol Nikollaj!

Përshëndetje (Shqiptare)

Unë do të doja të ju përshëndes në emër të Këshillit Rajonal Pan-Evropian (PERC) - një organizatë që bashkon më shumë se 70 milionë punëtorë të kontinentit tonë. Si President i PERC ju përshëndes ju dhe 160 000 qytetarët tuaj të nderuar, të cilët janë të bashkuar në Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH).

Po, unë ju them qytetarë të nderuar, sepse ata janë të ndershëm dhe jo thjesht qytetarë të zakonshëm; njerëz që ndejne solidaritet, mbështetje dhe ndjeshmëri për problemet e një personi tjetër dhe që mendojnë për fatin e dikujt tjetër dhe jo vetëm për veten e tyre. Kjo është me të vërtetë një sindikate me anëtare të nderuar. Dhe 160 000 vëllezërit dhe motrat tona i përgëzoj në 25 vjetorin e organizatës. Sulmet terroriste në Bruksel që ndodhën në mars, për fat të keq, më kanë penguar tju dergoj urimet e mia për vëllezërit dhe motrat e mia nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura Shqiptare (BSPSH) në përvjetorin e tyre dhe te vizitoja më parë këtë vend të bukur me njerëz dhe histori të bukur. Por pastaj "më mirë vonë se kurrë." Qëkur unë i mbijetova sulmit terrorist, tani kam ambicie që përpjekjet tona të përbashkëta do të mposhtin terrorizmin, errësirën e fanatizmin fetar, trafikimin, punën e detyruar, pabarazinë, lakmia e neoliberalizmit... Si mund ta bëjmë këtë? Përmes edukimit! Dialog social të mirë dhe me rezultate të orientuar në të gjitha nivelet! Shpërndarja e barabartë e pasurisë ekonomike, që do të thotë përfshirjen dhe respektin e sindikatave! Mbështetja e emigrantëve në vendet pritëse dhe duke u kujdesur për të drejtat e tyre në vendet e origjinës së tyre! Me pak fjalë, ky ishte programi im në zgjedhjet si kandidat për president dhe këtu sindikatat shqiptare më mbështetën, fakti që

kam që une I vleresoj shume. Unë jam i sigurt se ne nuk do të kursejmë asnjë përpjekje për të zgjidhur këto probleme.

Përveçse nga të qenit president i PERC, unë jam Kryetar i Konfederatës te Sindikatave Gjeorgjiane (GTUC) në Gjeorgji - një vend po aq i vogël si Shqipëria, por është i populluar nga njerëz krenarë si ju të cilët po përpiqen për të kombinuar ne menyre harmonike kulturën e saj të bukur dhe të pasur dhe traditat me vlera evropiane.

Për ne, ndarjen e përvojave te fituara nga Shqipëria është shumë interesante. Natyrisht ne kemi nevojë për të ndarë përvojën pozitive me njëri-tjetrin dhe kështu forcojmë njëri-tjetrin!

Kur biznesi thotë se bota është globale dhe se ata mund të marrin biznesin e tyre kudo që ata duan, ne duhet t'u tregojme atyre se po bota është globale dhe se të drejtat duhet të mbrohen jo vetëm në SHBA, Gjermani dhe Angli, por edhe në Bahrein , Zvicër, Gjeorgji dhe Shqipëri. Kudo ku janë vëllezërit dhe motrat tonë sindikaliste, ne duhet të luftojmë. Dhe në qoftë se dikush nuk e di se si të luftojmë, le t'u pyesin ekipin e futbollit shqiptar, i cili ka dëshmuar në Francë se lufta gjithmonë ka kuptim.

Së fundi, do të doja që edhe njëherë t'ju përgëzoj dhe t'ju uroj punë të suksesshme, që do të përfitojë zhvillimi i vendit tuaj dhe mirëqenia e punëtorëve të saj. Ky bashkim, solidaritet dhe bashkëpunim do të na sjellë sukses në këtë drejtim!

Faleminderit!